




REPUBLIKA E KOSOVËS	KOMUNA E VUSHTRRISE SË KOSOVËS
01 Nr. / Br.	135/11
Nr. i sq. / Br. si	
Data: / Datum	30. 06. 2011
VUSHTRRI	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS, VUSHTRRI

Bazuar në dispozitat e nenit 2 Pika 9 nenit 99, 100, 101 dhe 102 të Ligjit nr. 02/L – 70, për sigurinë në komunikacionin rrugor, të nenit 17 shkronjat f dhe n të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të nenit 6 të Ligjit nr. 2004/1, për transportin rrugor, të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2009 - PK dhe nenit 31 pika 2 shkronja “a” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2011, miraton:

RR E G U L L O R E N

PËR

SHËRBIMIN E TRANSPORTIT ME “MERIMANGË” PËR TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRISË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Në bazë të kësaj Rregulloreje, përcaktohen kushtet dhe mënyra e zhvendosjes së automjeteve të ndalura ose të parkuara në rrugë, apo në hapësira tjera të ndaluara, ku rrezikohet siguria në komunikacion ose pengohet rrjedha normale e komunikacionit si dhe ushtrimi i shërbimit të transportit me “merimangë” në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Shërbimi i transportit me „merimangë”

2.1 Shërbimi i transportit me “merimangë” nënkupton tërheqjen - bartjen e automjeteve që merren nga vendet ku është e ndaluar ndalja dhe parkimi i tyre, nga vendet ku ka ndodhur aksidenti në komunikacion, automjetet që mund të jenë të

3.7 Operatori i transportit me "merimangë", do të caktohet përmes tenderit të shpallur për kryerjen e shërbimeve të transportit me "merimangë", në bazë të kushteve më të volitshme të ofruara.

3.8 Ndërmarrja biznesore e licencuar nga Komuna, për zhvendosjen e automjeteve duhet t'i ketë edhe pajisjet për blokimin e automjeteve.

Neni 4

4.1 Operatori i transportit me "merimangë" do të caktohet përmes tenderit të shpallur për kryerjen e shërbimeve të transportit me "merimangë", në bazë të kushteve më të volitshme të ofruara.

4.2 Komuna do të lidhë kontratë me operatorin e transportit - fituesin e tenderit për transport me "merimangë", me të cilin do t'i përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese.

4.3 Kontrata nga paragrafi paraprak, lidhet për kohë të caktuar deri në një (1) vit, me mundësi vazhdimi.

Neni 5

Obligimet dhe përgjegjësitë e operatorit

5.1 Operatori është përgjegjës të plotësojë të gjitha dokumentet e nevojshme gjatë kryerjes së sigurimit fizik të autoparkut.

5.2 Afati për sigurimin e autoparkut zgjatë derisa zgjatë kontrata e térheqjes.

5.3 Operatori është përgjegjës në rast keqpërdorimi, dëmtimi eventual gjatë ngarkimit -shkarkimit, bartjes deri në dorëzimin e automjetit në autopark (dëmin eventual të shkaktuar obligohet t'ia kompensojë pronarit të automjetit).

5.4 Pas dorëzimit dhe vendosjes së automjetit në parking, përgjegjësia bie mbi personelin e sigurimit të autoparkut deri të bëhet térheqja e automjetit nga pronari.

Neni 6

Kushtet për shërbimin e transportit me "merimangë"

Operatori i cili ushtron këtë veprimtari, duhet t'i plotësojë këto kushte:

6.1 të jetë i regjistruar për ushtrimin e shërbimit të transportit me "merimangë",

6.2 të ketë së paku dy automjete për bartjen e automjeteve,

6.3 të ketë sistemin funksional të radio-lidhjeve,

6.4 të sigurojë shërbimin 24-orësh, gjatë shtatë ditëve të javës,

6.5 të ketë në dispozicion linjë telefonike,

6.6 të ketë numër të mjaftueshëm të personelit për ushtrimin e veprimtarisë (për një automjet për bartje, të ketë ngasësin dhe ndihmësin).

9.2. Zhvendosja e automjeteve nga paragrafi 1 i pikës 9.1, nga zona jashtë qytetit, pa ngarkesë, i shtohet vlera 0.25 € për 1 km, ndërsa me ngarkesë 0.50 € për 1 km. Të njëjtat tarifa vlejnë edhe për paragrafin 2 të pikës 9.1.

9.3. Në rastin kur zhvendosja e automjetit vetëm fillon, por nuk bëhet zhvendosja deri në vendin e ruajtjes, zbatohet çmimi si vijon: në zonën urbane 15 €, ndërsa jashtë zonës urbane zbatohet paragrafi i pikës 9.2.

9.4 Kur automjeti i zhvendosur pas kalimit të kohës prej njëzetekatër orësh nuk merret nga pronari ose shfrytëzuesi siç përcaktohet në këtë Rregullore, ruajtja, përkatësisht qëndrimi i mëtutjeshëm i automjetit për një ditë qëndrimi dhe ruajtje, do të paguhet çmimi prej 5 €.

9.5 Për zhbllokimin e automjeteve, autobusëve, automjeteve transportuese, automjeteve të punës dhe rimorkiove, duhet paguar 15 €.

9.6 Kur automjeti i bllokuar pas kalimit të kohës prej njëzetekatër orësh, kur pronari ose shfrytëzuesi i automjetit nuk përmbrush detyrimet për zhbllokimin e automjetit siç përcakton kjo Rregullore, ruajtja përkatësisht qëndrimi i mëtutjeshëm i automjetit nën bllokim, për një ditë qëndrimi dhe ruajtje duhet paguar 20 €.

9.7 Të gjitha pagesat nga parografi paraprak do të bëhen sipas kontratës, përmes bankës.

9.8 Taksat e shërbimeve do t'i vërtetojë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

9.9 Për secilën pagesë do të lëshohet fatura, e cila do të jetë me numër serik dhe do të përbajë këto të dhëna:

- markën dhe modelin e automjetit,
- numrin e targave,
- emrin e plotë, adresën dhe numrin personal të personit që i lirohet automjeti,
- datën e bllokimit të automjetit,
- datën e lirimit të automjetit dhe vendin e lirimit (në vendqëndrimin e automjeteve apo në vendin ku është bllokuar).

Neni 10

Puna me bllokues

10.1 Sipas kësaj Rregulloreje, operatori i licencuar nga Komuna duhet të jetë i pajisur me bllokues.

10.2 Sistemi i vendosjes së bllokuesve kryhet nga punëtorët e operatorit, në marrëveshje me policinë, në çdo kohë dhe në çdo vend.

10.3 Automjetit të cilit i vendosen bllokuesit, pronari i tij obligohet të paguajë gjobën sipas nenit 9, parografi 9.5 të kësaj Rregulloreje.

10.4 Në rast se pronari, përkatësisht drejtuesi i automjetit, largon automjetin para se të arrijnë punëtorët për vendosjen e bllokuesve, ai paguan gjobën sipas nenit 9, paragrafit 9.3 të kësaj Rregulloreje.

komunal dhe të komunikacionit), këto automjete zhvendosen në depon e mbeturinave.

13.2 Shpenzimet e zhvendosjes së automjetit në depon e mbeturinave i bart pronari i fundit i automjetit, nëse kjo mund të konstatohet në bazë të dhënave të regjistrimit të automjetit nga evidenca e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në të kundërtën, bie në barrë të Komunës.

13.3 Para se të bëhet zhvendosja e automjeteve të braktisura, operatori i licencuar nga Komuna për zhvendosjen e automjeteve, përmes ekspertit përkatës, konstaton vlerën reale kushtuese të automjetit.

13.4 Automjetet e braktisura (me motor) që gjenden në vendet publike, kompania do t'i dërgon në autopark, dhe nëse brenda 6 muajve pronari nuk e tërheqë automjetin e vet, i njëjti do të procedohet në ankand publik që të shitet.

Neni 14

Zbatimi i Rregullores

14.1 Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdesen Organet kompetente Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria e Inspeksionit dhe Policia e Kosovës.

14.2 Në rast të shkeljes së ndonjërs nga dispozitat e kësaj Rregulloreje, Drejtoria mban të drejtën e shkëputjes së kontratës me operatorin.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 15

Për të gjitha çështjet tjera, të cilat nuk janë paraparë në këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 02/L – 70, për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe dispozitat e Udhëzimit administrative nr. 02/2009 - PK.

Neni 16

Rregullorja hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

